



Data 15/08/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale konsumi mjekësore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote”,

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Materiale mjekësore të konsumueshme, 33140000-3

Materiale mjekësore konsumi jo-kimike dhe hematologjike 33141000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit i Marrëveshjes Kuadër/Vlerë e Pritshme për të gjitha lotet, rezulton: **344,198,549.2** (treqind e dyzet e katër milion e njëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e dyzet e nëntë pike dy) **lekë pa TVSH dhe 413,038,259.04** (katërqind e trembëdhjetë milion e tridhjetë e tetë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë pike zero katër) **lekë me TVSH**, e konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 15/08/2024: **3,449,229** (tre milion e katërqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) **euro pa TVSH**, e ndarë në lote si më poshtë:

- **Loti 1 - Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore: 186,956,900** (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind) **lekë pa Tvsh dhe 224,348,280** (dyqind e njëzet e katër milion e treqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e tetëdhjetë) **lekë me Tvsh**, e konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 15/08/2024: **1,873,503.4** (një million e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tre pike zero katër) **euro pa TVSH dhe 2,248,204** (dy milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e katër) **euro me TVSH**.
- **Loti 2 - Materiale mjekimi konsumi dhe kirurgjikale per nevoja spitalore: 157,241,649.20** (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milion e dyqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e dyzet e nëntë pike dy) **lekë pa TVSH dhe 188,689,979.04** (njëqind e tetëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pike zero katër) **lekë me Tvsh**, e konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë e konvertuar në Euro sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 15/08/2024: **1,575,725.5** (një milion e pesëqind

e shtatëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë pike pesë) **euro pa TVSH** dhe **1,890,870.6** (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë pike gjashtë) **euro me TVSH**.

Vlerat janë konvertuar në Euro, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 15/08/2024 me kurs këmbimi 99,79 lekë.

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është (në total për të gjitha lotet): 571,997.13** pesëqind e shtatëdhjetë e një mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë pikë trembëdhjetë) **lekë pa TVSH**. Shumatore e çmimeve për njësi në euro: **5,732** (pesëmijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) **euro pa TVSH**, e ndarë në lote.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor **Qendra Spitalore Universitare “Nene Tereza” Tirane** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e përcaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**”, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autodeklaratë** për certifikimin **ISO 9001:2015** mbi “**Sistemet e menaxhimit të cilësisë**” ose certifikimin **ISO 13485:2016** “**Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë për Pajisjet Mjekësore**” ose **ekuivalent, të prodhuesit**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Shënim: OE, në rastin e renditjes i pari dhe përpara njoftimit të fituesit, duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të prodhuesit sipas vetëdeklarimit të bërë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

c) Kerkohet **Autodeklaratë** për materialet mjekësore nga ofertuesi (distributori / prodhuesi) për konformitetin me normat MDD 93/42/EEC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), ose EU Regulation 2017/745 ose 98/79/EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë) ose 98/34 EC (sipas aplikimit të vlefshmërisë), bashkëlidhur me kopjet e çertifikatave përkatëse FDA ose CE/DC (Deklaratë Konformiteti) sipas aplikimit, në përputhje me Direktivat dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, origjinale ose fotokopje (të njësuara me origjinalin) dhe nëse nuk janë në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehen në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohen.

Argumentimi: Kriteret e percaktuara në piken a), b) dhe c) është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020”Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejme të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatatë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, object prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë*

ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organisma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe nëmënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2021, 2022 dhe 2023) ku vlere e tyre te jete **jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.**

*Shënim**: Për efekt të përlogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlere mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të lotit/shumës së loteve që aplikon OE/BOE, të parashikuar sipas sasive të pritshme për të cilen ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlere e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 /2.14

Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”, ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastiit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/a: 2. Vlere e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros jo me e vogel se **40 % e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurron operatori, eshte nje deshmi e mjaftueshme per te krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 ‘Mbi Rregullat e Prokurimit Publik’ ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

a) **Deshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një autoritet / ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose / dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të lotit/shumatores së loteve që aplikon OE/BOE, të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10/ 2.14

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejmë te percaktuar se: *4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU "Nënë Tereza" Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes

tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **autorizim nga firma prodhuese / MAH / distributori i autorizuar**, (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) **per tregtimin e mallrave objekt prokurimi**. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose fotokopje (e njëhësuar me origjinalin) dhe nëse nuk është në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehet në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbështetje te Relacionit nr. 100/22 prot., datë 29.07.2024 ‘Argumentimi I nevojave, specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**”, bashkelidhur kërkesës nr. 100/23 prot, datë 01.08.2024 të Drejtorisë së Sherbimit Farmaceutik, dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje ne pikat 2 dhe 4 te nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe piken 5 te nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ku eshte e cituar: 5. *Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Autorizimi per OE ofertues nga firma prodhuese ose nga distributor I autorizuar prej prodhuesit është një dokumenti domosdoshëm për t’u paraqitur, në mënyrë që autoriteti kontraktor të sigurohet që subjekti/shoqëria që disponon këtë dokument, autorizon operatorin ekonomik që ta furnizojë me produktet e tij; domosdoshmëria e tij lidhet me garancinë e mallit të cilën e jep prodhuesi dhe jo operatori ekonomik ofertues (*ref. Vendimit te KPP nr. 353/2014*). Ky kriter u mbështet edhe në **Rekomandimin nr. 3341/1 prot. Date 20.03.2018 te Agjensise se Prokurimit Publik** (Drejtoria Juridike dhe Monitorimit) drejtuar Autoriteteve Kontraktore ”**Rekomandim mbi hartimin e kriterëve per kualifikim ne dokumentet e tenderit te procedurave te prokurimit publik**”.

c) Per artikujt objekt prokurimi të shenjuar me asterisko (*), ofertuesi duhet te paraqesë mostra në ditën e hapjes/dorëzimit të ofertave, me date __.__.2024 ne oren **10:00**. Dorezimi i Kampioneve/mostrave, te behet prane Drejtorise Juridike/Sektori Prokurimeve, QSU ”Nene Tereza”, te mbyllura ne nje zarf /kuti jo transparente te vulosur mbi te cilin te shenohet:

- “*Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit: “Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote”, LOTI _____, dhe jo para datës __./2024, ora 10:00 (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).*

- *Se bashku me mostrat ofertuesi duhet te japë edhe një shkrese te vulosur dhe firmosur ku te listohen mostrat qe ndodhen ne zarf/kuti.*
- *Mbi çdo mostër te dorëzuar, ofertuesi duhet te shënoje Nr. Rendor te Artikullit qe përfaqëson sipas formularit te çmimit.*
- *Ne paketimin e çdo mostre duhet te evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet te përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.*

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë te shoqëruara me listën e inventarizimit dhe te identifikuar sipas Nr. Rendor te formularit te çmimit, nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te skualifikohet.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbeshtetje te Relacionit nr. 100/22 prot., datë 29.07.2024 ‘Argumentimi I nevojave, specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje materiale konsumi mjekesore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote**”, bashkelidhur kërkesës nr. 100/23 prot, datë 01.08.2024 të Drejtorisë së Sherbimit Farmaceutik, dhe u miratua nga anetarët e Njesise se Prokurimit qe ka specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike. Gjithashtu ky kriter gjen mbeshtetje ne piken 6 te nenit 40 te të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se:6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial 39 tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. Ky kriter gjithashtu gjen mbështetje në Udhëzimin e APP nr. 3, datë 12.04.2022 ‘Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga OE’.*

Paraqitja e mostrave per artikujt qe jane objekt prokurimi, eshte kerkuar me qellim verifikimin e perputhshmerise ne vend te materialeve objekt prokurimi qe operatori ekonomik oferton me specifikimet teknike te percaktuara ne DST ne Shtojcen 5, dhe duke qene se ato kane nje natyre te vecante, per te bere te mundur vleresimin e tyre eshte i nevojshem vlerësimi i tyre.

ç) Për të gjithë artikujt (materiale mjekësore, konsumablet etj.) e ofruar dhe që janë pjesë e tabelave të pasqyruara në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike /specifikimi i materialeve*), **duhet të paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike te hollësishme për secilin**

artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet) nëse katalogjet e paraqitura nuk janë në gjuhën angleze ose shqipe, të përkthehen në gjuhën angleze ose shqipe dhe të noterizohen. Operatori ekonomik **duhet të markoje ne katalogun perkates produktet për të cilat oferton**, sipas numrit rendor të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Ky kriter është bazuar në Relacionin nr. 100/22 prot., datë 29.07.2024 ‘Argumentimi I nevojave, specifikimeve teknike dhe llogaritja e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt “**Blerje materiale konsumi mjekësore për 12 Muaj e ndare në 2(dy) lote**”, bashkelidhur kërkesës nr. 100/23 prot, datë 01.08.2024 të Drejtorisë së Sherbimit Farmaceutik, miratuar nga anetari i Njesise se Prokurimit që ka specialitet perkatese në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, si dhe me piken 6/b të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është e percaktuar se: [...] 6. *Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të percaktuara në dokumentet e tenderit, si: [...] b. fotografitë apo katalogët teknikë; [...].*

Paraqitja e katalogjeve për të gjithë artikujt që janë objekt prokurimi, është kërkuar me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së paisjeve mjekësore që operatori ekonomik oferton, me specifikimet teknike të percaktuara në DST në Shtojcën 5.

d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë **oferten teknike** për artikujt e kërkuar, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese për produktet.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur nga anetari i Njesise se Prokurimit që ka specialitet perkatese në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me **piken 1 të nenit 36 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Per Prokurimin Publik”**, në të cilën është e percaktuar se:

1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi..

Gjithashtu ky kriter është ne perputhje me pikën 2 të Nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se:2. *Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.*

Ne kete kontekst është kërkuar dhe oferta teknike, me ane të se ciles do të behet e mundur verifikimi me i sakte i artikujve të ofertuar, specifikimeve të tyre, origjina, konformiteti etj., me dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga ofertuesi.

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bejë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.

- Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 5.

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Blerje materiale konsumi mjekësore per 12 Muaj e ndare ne 2(dy) lote”,

Lot 1 'Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore'			
Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
Garza, Bende, te tjera konsumable te pergjithshme			
1*	Bende 7cm x 4 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
2*	Bende 10 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
3*	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm2	Copë
5*	Bende adesive 10 cm x 15 m	Cope e pathurur poroze, elastike. Ana ngjitese e mbrojtur me leter te shqiteshme	Copë
6*	Bende 20 cm x 10 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
8*	Bende 8cm x 5 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	Copë
10*	Komprese sterile 5cm x 5cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 6pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
11*	Komprese sterile 10cm x 10cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
12*	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 8pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë
13*	Komprese sterile 10cm x 20cm	100% pamb absorbent, dendesia 24x20, 12pala; jo me shume se 5 cope/pako	Copë

16*	Komprese antimikrobiale 10x10cm	E perbere prej materiali absorbues te imprenjuar me polyhexanide / Ag.	Copë
17*	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm ² , fibrile kolageni ose ekuivalent 2.8 mg/cm ²	Copë
18*	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako	Copë
19*	Garze 91 cm x 100 m	100% pambuk absorbent, dendesia 24x20	m. linear
20*	Fiksues kanjule	Fiksues kanjule / afersisht 8.5 cm x 6 cm / materjali , TNT adezive hipoalergjik /poliuretan dhe me garze perthithese ne mes, me kompresim te dyfishte .	Copë
21*	Pambuk kirurgjikal	100% pambuk hidrofil, pakete 100g	Copë
22*	Pulla injeksioni	Dimensionet e peraferta: 0.9 cm x 3.8 cm , me garze perthithese ne mes dhe dy anet me ngjites antialergjik	Copë
23*	Leukoplast 5cm x 5m	cope 100% pambuk, ngjites me permbajtje oksid zingu	Copë
24*	Leukoplast antialergjik 5cm x 5m	cope e padeptueshme mendafshi, me ngjites antialergjik	Copë
Sisteme dhe doreza			
27*	Sisteme infuzioni	Sistem infuzioni transparente dhe fleksibel e pershtatshme si per shishet edhe per qeset e infuzionit, e pajisur me valvol ajrimi + filter + age , luer luck + bashkuese e gomuar ne forme "Y" ose "flashball" , me PP flow rregullator , 20 pika / 1ml , e paketuar me qese te sterilizuar .	Copë
28*	Doreza ekzaminimi (ndare sipas numrit)	Josterile , me latex natyral , me puder , me permasa XS, S, M, L.	Copë
29*	Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)	Doreza kirurgjikale me puder, latex natyral, paketuar ne zarfe letre te sterilizuar me rreze Gama ose gaz Etilen sipas normativave EN; madhesia 6.5, 7, 7.5, 8, 8.5	pale
30*	Lama bisturie	Nr: 15, 20, 21, 22, 23, 24	Copë
Materiale konsumi per respirim, aspirim, infuzion			
31*	Filter baktericid	per respirim artificial, antibakterial, HMEF	Copë
32*	Qarqe respiratori	per respirim artificial L= 1.5 m; ID 22 mm	Copë
33*	Absorbues CO ₂ per Anestezi	Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14.	Kg

		Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.	
34*	Tuba Guedel	Nr. 00, 0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8	Copë
35*	Maske oksigjeni	me zgjatues L=1.5-2m	Copë
36*	Sonde oksigjeni adult	nazale, adult, L=1.5-2 m	Copë
37*	Sonde oksigjeni pediatrike	nazale, pediatrike L=1.6+0.6 m, diam .4 mm	Copë
38*	Kanjula nazale per CPAP	Per infant, ne permasa te ndryshme dhe tipologji sipas autoritetit kontraktor	Copë
39*	Komplet aerosoli me tub zgjatues 1.5m	maske me rezervuar per medikamente	komplet
41*	Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22	Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)	set
42*	Dren pleural	Tip trocar me brima anash	Copë
43*	Dren silikoni	Ch 16-28, L=50cm, me vrima a neseore i detektueshem nga rrezet X	Copë
44*	Dren Kehr	silikon, Ch 10-14-16-18-20	Copë
45*	Tub drenimi	silikon, rulon 20-30m, diam. 6-8mm dhe 8-10mm	meter
46*	Tub drenimi penrose	100% silicon transparent, opak x-ray, gjeresia 20, 25, 35mm , L=40-50cm.	Copë
47*	Dren torakal I drejte dhe anguluar	PVC, Ch16-Ch32	Copë
48*	Dren abdominal double drain me katere te brendshem		Copë
49*	Dren me troakar	Ch12-Ch20	Copë
50*	Pleurovac me regullator tub zgjates me varse per krevat	3-chambers, tub zgjatues silikoni 1.8-2m, vellimi mbi 2100-2500ml, pajisur me rregullatore te integruar presioni dhe lageshtie dhe valvol sigurie	Copë
51*	Set steril per funksionim vezike urinare	I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem	set
53*	Set steril per urografi retrograde	stente, klem, tub per kontrast bashkuese, (shiringe)	set
54*	Set pediatrik steril per drenim te vezikes urinare	Kateter , dilatator	set
55*	Set steril per drenim renal perkutan	set nefrotomie me age, introduktor, gide metalike, dilatatore, kateter L=20-30cm Ch 8-12	Copë
56*	Stente ureterale	Set, stente double, J, 6Fr, 24-28mm, gide , pusher	Copë
57*	Intraduktor jugular	per adulte	Copë
58*	Maske per terapi CPAP	Madhesi e adoptueshme nga masa S deri ne L	Copë
59*	Lageshtues per CPAP	Me tub konektor	Copë
60*	Anse bipolare	Per resektoskop bipolar, 24Fr / 26 Fr, per urologji & gjinekologji.	Copë

61*	Anse monopolare	Per resektoskop monopolar, 24Fr / 26 Fr, per urologji & gjinekologji.	Copë
62*	Ansa koagulimi	Per resektoskop monopolar 24Fr, me rul sferik	
63*	Vaj silikon	Per litotripsi ekstrakorporale; shishe 500ml	Copë
64*	Set tubimi laparoskopik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set
65*	Set tubimi endourologjik, steril	Per irrigim te drejtuar, me dy age punkcioni, me membrane per monitorim te presionit te irrigimit.	set
68*	Age insuflimi pneumoperitonik	Tip Veress, L=120÷150 mm	Copë
69*	Solucion glicerine	Ne shiringe 10 ml, solucion uje steril 90% dhe glicerine 10%, per urologji.	Copë
70*	Kateter epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+filter	Copë
71*	Set epidural	kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+ shiringe	set
72*	Kateter venoz Seldinger 2-rruges	me dy rruge, tip Seldinger, L=20-30cm	Copë
73*	Kateter arterial	20G-22G Seldinger	Copë
74*	Kateter embolektomie	Me ballon, nr. 3, 4.	Copë
75*	Aparat klizme adult		Copë
76*	Urinokol pediatrik		Copë
80*	Zhgute		Copë
81*	Tuba endotrakeale pediatrike	ID 2 - 5mm, nazal/oral	Copë
82*	Tuba endotrakeale adult	ID 5.5mm-8.5mm, nazal/oral, me ballon	Copë
83*	Kateter aspirimi pediatrik	Ch 8, 10	Copë
84*	Kateter aspirimi adult	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
85*	Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi	Ch 8, 10	Copë
86*	Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi	Ch 12, 14, 16, 18.	Copë
87*	Set aspirimi	Set =(kanjule 26x6mm+tub 1.8-2.5m)	set
88*	Tub endobronkial	PVC e silikonizuar, me dy balona presioni, maje atraumatike, vijezim i detektueshem nga x -ray pergjate tubit, i graduar, me dy konektore 15 mm, me grep per carina; 35FR , 37Fr, 39Fr, 41Fr	Copë
89*	Tub endotrakeal 7.5	ID 7.5 mm, nazo-oral, me ballon	Copë
90*	Tub endotrakeal 8.0	ID 8.0mm, nazo-oral, me ballon	Copë
92*	Maske Laringeale Silikon	Maske Silikon me nje perdorim. Madhesia Nr.1÷5	Copë
93*	Kateter lavazhi bronkial	Dy-rruges, per lavazh dhe aspirim bronkial. Fr 10-16, gjatesia mbi 45cm.	Copë

94*	Kateter me ballon per hemorragjine pas lindjes	Set steril per nderprerjen dhe menaxhimin e hemorragjise pas lindjes. Seti : Kateter silikoni Fr 24-25 me kanal per monitorim drenimi, ballon 500-600 mL, shiringe 50/60mL, set infuzioni, valvul 2-rrugeshe	set
95*	Kateter me ballon per dilatacionin e columit	Induktor dilatacioni me ballon te dyfishte 2 x 80-90mL, kateter silikoni 2/3 lumen 16-18Fr, 40-50cm, udhezues metalik; set steril.	Copë
97*	Set punkSIONI pleural	Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.	Copë
98*	Petzer	Nr 18-20-22-24	Copë
100*	Qese ekstraktimi e vogel	Vellimi 180-220ml, me dy seksione, seksioni punues me diameter 7- 8cm, me lak mbylles, per laparoscopi me trokare 10-11mm	Copë
101*	Qese ekstraktimi e madhe	Vellimi 250-300ml, me dy seksione, seksioni punues diameter 9-11cm lak mbylles, per laparoscopi me trokare 10-11mm	Copë
Materiale konsumi per monitorim diagnostike			
102*	Leter printeri ECHO		Copë
103*	Leter printeri fotografike		Copë
105*	1-3 kanale		Copë
106*	3-kanale		Copë
107*	6-12 kanale		Copë
110*	Xhel per ECHO	Bidone 5 kg , Xhel - Transonic / Transparent , densiteti - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
111*	Xhel per EKG	Bidon 5 kg , Elektro-Xhel / ECG , densiteti - - 1/02 gr /ml + nje pistone dhe dy shishe 250 ml boshe , per cdo kater bidona	Copë
112*	Elektroda monitorimi EKG	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe	Copë
113*	Elektroda EKG neonatale	Elektroda monitorimi njeperdorimeshe per neonate	Copë
114*	Elektroda Defibrillatori	Cift elektroda per defibrilator njeperdorimeshe me konektor. Sterile. (modeli i pajisjes do te percaktohet nga autoriteti kontraktor)	set
115*	Aparat tensioni	Me manometer	Copë
116*	Steto-fonendoskop	Koke e sheshte	Copë
117*	Ndricues oral	Me bateri;	Copë

118*	Termometer	termometer pacienti	Copë
119*	Spatula (druri)	Sterile, e paketuar individualisht	Copë
120*	Set Pap testi	I perbere nga 1.Spatul druri per Pap Test - STERILE, e paketuar individualisht 2. Citobrusch - STERILE, e paketuar individualisht 3. Xhama mikroskopi i poshtem - 26x76 mm - Menzel me ane dhe buze mbesheteses 4. Xhama mikroskopi i siperm - 22x22 mm - Menzel 5. Speculum (permasa te ndryshme)	set
122*	Gojez spirometrike		Copë
123*	Filter spirometrik antibakterial		Copë
124*	Set Filter spirometrik antibakterial	Set i perbere nga: filter antibakterial, gojez spirometrike, dhe klipi nasal	Copë
126*	Set ngrohës per lageshtues	Set i perbere nga: tel ngrohës, adaptor, sensor nonitorues per lageshti-temperature per qark pacienti me lageshtues.	set
127*	Dome steril	per transduser presioni invaziv shumepdorimesh (modeli i transduserit percaktohet nga autoriteti kontraktor)	Copë
128*	Set Presioni Invaziv	Set monitorimi IBP me nje perdorim. (Transducer+linje monitorimi) (modeli i pajisjes do te percaktohet nga autoriteti kontraktor)	set
129*	Paste EEG / EMG	Adhesive ose Abrasive 250g	Copë
130*	Set Elektroda Aurikulare EEG	Cift elektroda aurikolare. Permbajtje Ag dhe konektor 100-150cm.	set
131*	Elektrode rrethore EEG	Permbajtje Ag dhe kabell 90-100cm	Copë
132*	Elektrode EEG tip ure	Elektrode ure per EEG	Copë
133*	Age elektrode EMG	monopolare, aplikim nen lekure, 12÷15mm/0.4mm	Copë
134*	Sonde stimulimi EMG bipolare	bipolare, concentrike, 45÷50mm. Kabell 200÷250cm	Copë
135*	Sonde stimulimi EMG monopolare	monopolare, sferike, L=30÷35mm. Kabell 200÷250cm	Copë
136*	Kateter monitorimi te performances kardiake	Kateter shume-rruges me ballon per monitorim invaziv te outputit kardiak.	Copë
137*	Sensor oksimetrie neonatal	Per monitor pacienti; set njeperdorimesh neonatal me sensor oksimetrie dhe kabllin perkates	Copë
138*	Sensor oksimetrine	Per monitore pacienti. Shumepdorimesh	Copë
139*	Mansheta monitorimi TA	Per monitore pacienti. Shumepdorimesh	Copë

Lot 2 'Materiale mjekimi konsumi kirurgjikale për nevoja spitalore'			
Nr	Artikulli	Specifikime teknike	Njësia
Materiale mjekimi per Anestezi -reanimacion			
1*	Kanjule intravenoze	14G , me valvol	Copë
2*	Kanjule intravenoze	16G , me valvol	Copë
3*	Kanjule intravenoze	18G , me valvol	Copë
4*	Kanjule intravenoze	20G , me valvol	Copë
5*	Kanjule intravenoze	22G , me valvol	Copë
6*	Kanjule intravenoze	24G, me valvol	Copë
7*	Age mielogramme me doreze	Tip troakar, 16-18G, L=75-90 cm, me doreze regjistruese	Copë
8*	Age spinale e zakonshme	22G - 26G, L=7-9 cm	Copë
9*	Age spinale atraumatike	Pencil point; 22G - 26G; L=7-9cm	Copë
10*	Kateter zgjatues arterial	Zgjatues 120-150cm	Copë
11*	Kateter zgjatues venoz	Zgjatues 120-150cm	Copë
12*	Ventil tre-rruges		Copë
13*	Ventil tre-rruges me zgjatues	Tub 10-25 cm gjatesi	Copë
14*	Kateter urinar Nelaton	Fr 08-20, male	Copë
15*	Kateter Foley 2-rruge	Silikon Foley Ped-adult 2-rruge 12G-20G	Copë
16*	Kateter Foley 3-rruge	Silikon Foley Ped-adult 3-rruge	Copë
17*	Kateter gastro-duodenal	Mono lumen	Copë
19*	Sonde rektale		Copë
20*	Sonde rektale pediatrike		Copë
21*	Qese urine	2000ml, me valvol	Copë
22*	Qese urine pediatrike	jo më shumë se 1000ml, me valvol	Copë
23*	Age spinale pediatrike		Copë
24*	Set aspirimi kanjule me tub	1.8 deri 2.5 m+kanjule 26X6 mm	Copë
25*	Kanjule trakestomie	4, 4.5, 5.5, 6 mm me ballon	Copë
26*	Kanjule trakeostomie 100% silikon	7,7.5,8,8.5 mm me ballon	Copë
27*	Gjuheza per laringoskop me kamera	Paketim steril, material polimer optik, Nr.2,3,4	Copë
28*	Age biopsie semi automatic	14G-100mm	Copë
29*	Age localization mamaro	Type Z 20G-50mm	Copë
30*	Age aspirimi	Age aksesi pedikular me maje troakar	Copë
37*	Sonde blakemore	Nr. 16, 20	Copë

38*	Sfungjer Nazal pa fill, epistaksis	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, pa fibra, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 10 cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2.5 cm	Copë
39*	Sfungjer Nazal pa fill me tub ajrimi	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, trashesi 1.5 cm dhe lartesi 3 cm	Copë
40*	Sfungjer Nazal me fill	Me perberje polivinil acetat i hidroksilizuar, kompresim i dyfisht, me absorbim te larte, hemostatik dhe biokompatibel, me permasa: Gjatesi 8cm, gjeresi 1.5 cm dhe lartesi 2 cm	Copë
41*	Splint Intranazal Silikoni	Splint Intranazal Silikoni me tub ajrimi	Copë
Shiringa, Age			
42*	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
43*	Shiringa 20cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 20 G , 3 pjese,	Copë
44*	Shiringa 10cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 21 G , 3 pjese,	Copë
45*	Shiringa 5cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 22 G , 3 pjese,	Copë
46*	Shiringa 2cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile , me Age 23G , 3 pjese,	Copë
47*	Shiringa insuline	Sterile, tre pjeseshe, me Age 26G	Copë
48*	Age 18G	sterile	Copë
49*	Age 20G	sterile	Copë
50*	Age 21G	sterile	Copë
51*	Age 23G	sterile	Copë
52*	Age 25G	sterile	Copë
53*	Age flutur 18G	sterile	Copë
54*	Age flutur 20G	sterile	Copë
55*	Age flutur 22G	sterile	Copë
57*	Shiringa 50cc	Shiringe nje perdorimeshe , sterile me gryke hinke	Copë
Materiale nje perdorimeshe per kirurgji			
59*	Perparese vizitoresh	Perparese vizitoresh me peshe jo me pake se 20 gr , me minge elastike dhe jake rrethore	Copë
60*	Maske kirurgjikale	Cope e pathurur me 3 shtresa, celluloze , poliester , fiber , koficenti i filtrimit $\geq 99\%$, me pershtates per hunden dhe lidhese , dimesionet 90 mm x 180 mm , pesha 2.8 gr	Copë
62*	Kapuc per infermjere	Cope e pathurur me peshe jo me pak se 25 gr.m ² me fund elastik , pa latex.	Copë
63*	Qese per veshje kepucesh	Qese PVC, me mbyllje elastike	Copë

65*	Beze kirurgjikale aktive 7.5 cm x 7.5 cm	Cope e thurur, me thithje te shpejte per plage, me perberes polyakrylate (SAP) me veshje celuloze and solucion ringer, 7.5 cm x 7.5 cm ose ekuivalent	Copë
70*	Beze me vazeline	Beze me pomade te thjeshte (vazeline te bardhe, estere acid yndyror digliceroli te karbonateve dhe bikarbonateve, dyll sintetik) e pershkueshme nga ajri dhe eksudati, me shtrese te trashje qe nuk fshihet dhe ne rast te eksudatit masiv, jo alergjike, efektive dhe per trajtim afatgjate. 7.5cm x10 cm ose ekuivalent	Copë
71*	Beze hidroxhel	Beze e sfungjerte hidropolimere, hidroxheli me perberje poliure/poliuretan-poliuretan polimer, propilen glikol, me buze adezive poliakrilat. Permasa 15x15 cm;	Copë
Materiale qepes kirurgjikale			
Sutura mendafshi			
72*	Silk -USP 1, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
73*	Silk -USP 0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 40-50	me age 1/2 rrethore	Copë
74*	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-35	me age 1/2 rrethore	Copë
75*	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-35	age 1/2 rrethore	Copë
76*	Silk -USP 2-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 30-40	age 1/2 rrethore	Copë
77*	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-25	age 1/2 rrethore	Copë
78*	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore	Copë
79*	Silk -USP3-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	age 1/2 rrethore prerese	Copë
80*	Silk -USP4-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
81*	Silk -USP4-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-30	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
82*	Silk -USP4-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 20-26	me age 1/2 rrethore	Copë
83*	Silk -USP5-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore shpuese	Copë
84*	Silk -USP5-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 17-22	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
85*	Silk -USP6-0, Gjatesia fijos 70-90cm; dimesnioni i ageve 16-20	me age 1/2 rrethore prerese	Copë
86*	Nylon- USP 4-0; Gjatesia fijos 45-50 cm; Dimensioni i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë
87*	Nylon- USP 5-0; Gjatesia fijos 45-50 cm; Dimensioni i ageve 14-15	Monofilament I tejdukshem, age 3/8 rrethore, reverse cutting, slip point	Copë

88*	Silk -USP 1, Gjatesia fijes 70-90cm;	ligature pa age, 10 fije/pakete	Copë
